



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kuvendi i Komunës
Nr. 001/011 – 48187
Më: 31 mars 2022



001-011-48187 / Dt. 04.04.2022



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja s) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 25 paragrafit 1 shkronja o), nenit 27 paragrafit 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643 dt. 15 tetor 2008 Kuvendit i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2022, miratoi këtë:

**VENDIM
PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMUNALE PËR INFORMIM, KOMUNIKIM DHE
PJESËMARRJE QYTETARE 2022-2024**

Neni 1

Me këtë vendim, miratohet Strategjia Komunale për Informim, Komunikim dhe pjesëmarrje qytetare, për periudhën 2022-2024.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Strategjia Komunale për Informim, Komunikim dhe pjesëmarrje qytetare për periudhën 2022-2024.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi - strategjie do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Udhëheqësi i Njesisë për Komunikim me Publikun, si dhe drejtorët e drejtorive komunale.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

STRATEGJIA KOMUNALE PËR INFORMIM KOMUNIKIM DHE PJESËMARRJE QYTETARE 2022 - 2024

Prizren 2022

SHKURTESAT

IT	Teknologji e Informacionit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SWOT	Strengths-Weaknesses-Opportunities-Threats
USAID	United States Agency for International Development
TEAM	Transparent, Effective and Accountable Municipalities
ZKI	Zyra për Komunikim dhe Informim

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	4
2. SFONDI	4
2.1. Profili i komunës	5
2.2. Administrata komunale	5
2.3. Zyra për Informim Publik	5
2.4. Korniza Ligjore	6
3. GJENDJA AKTUALE ME INFORMIMIN DHE KOMUNIKIMIN	7
3.1. Komunikimi i brendshëm	8
3.2. Informimi	8
3.3. Komunikimet online dhe platformat sociale	8
3.4. Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje	9
3.5. Marrëdhëniet me mediat	9
3.6. Bashkëpunimi me aktorë të tjerë	10
3.7. Promovimi dhe marketingu i Komunës	10
3.8. Vlerësimi vetanak - Analiza SWOT	11
4. PLATFORMA PËR KOMUNIKIM	11
5. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT	12
<i>Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale</i>	13
<i>Krijimi i mekanizmave efikas për komunikim dhe informim publik</i>	14
<i>Rritja e cilësisë së informimit, transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë</i>	14
6. KANALET E KOMUNIKIMIT	14
7. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR	16
8. INTERVENIMET NË MEKANIZMAT E KOMUNIKIMIT	19
9. BUXHETI PROVIZOR PËR VITIN 2021	21
10. PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI	21
11. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	21
12. SHTOJCAT	22
Shtojca 1. Plani i Veprimit për Komunikim, Informim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2021	22
Shtojca 2. Plani i Veprimit për Transparençë 2019-2023	22

HYRJE

Komuna e Prizrenit në vazhdimësi është përpjekur që t'i përmirësojë dhe avancojë mekanizmat e vet të komunikimit me audiencat e shumta me synimin që t'u përgjigjet dinamikave të reja teknike dhe teknologjike dhe nevojave e kërkesave të qytetarëve për shërbime cilësore dhe informim të saktë e të kohshëm.

Qëllimi i hartimit të kësaj strategjie për informim dhe komunikim është që të mbështesë traditën tashmë të krijuar të komunikimeve të strukturuar në mënyrë që mekanizmat komunikues të jenë efikas, të përshtatshëm e të qëndrueshëm dhe si të tillë të mbështesin përmbushjen e misionit të komunës *për një shoqëri të hapur që promovon diversitetet dhe shkëmbim ide e mendimesh, duke i respektuar mendimet e të tjerëve.*

Kjo *Strategji për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2022-2024* është e përqendruar në rritjen e intensitetit të komunikimit dhe informacioneve në komunën e Prizrenit karshi audiencave të synuara dhe përvijon orientimet e administratës komunale për informim të kohshëm e transparencë qeverisëse, komunikim efikas, marrëdhënie të shëndosha me medie dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2022-2024 është zhvilluar mbi aspiratat e komunës për të avancuar me hapa të shpejtë duke përfitur nga avantazhet që ofrojnë zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i shtuar i mediave të reja si kanale të komunikimit. Përmes këtij Strategjie do të kërkohet një reagim pro-aktiv i audiencave ndaj punës, aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, medie, organizata të shoqërisë civile, hisedarë dhe partnerë që mbështesin nismat e komunës. Kjo do të arrihet përmes thëllimit të praktikave të komunikimit me audiencat e brendshme dhe të jashtme duke përdorur kanale të përshtatshme dhe efikase të komunikimit. Së këndejmi, Strategjia për Informim dhe Komunikim 2022-2024 është e një rëndësie të veçantë si për krijimin e urave të ndërveprimit me akterë të ndryshëm ashtu dhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të komunës.

Një strategji efikase e informimit dhe marrëdhënieve me publikun mbështetet fort në kontributin dhe rolin aktiv të të gjithë të punësuarve në administratën dhe institucionet komunale. Për këtë arsye, pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe komunikimi i brendshëm, si një komponentë që ekskluzivisht përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë.

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e objektivave të kësaj strategjie, Komuna do të krijojë mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të zyrtarëve për informim, kurse në raste të veçuara do të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale.

Hartimi i Strategjisë Komunale për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun 2022-2024 është realizuar me mbështetjen teknike dhe profesionale të USAID përmes projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (Transparent, Effective and Accountable Municipalities).

I. SFONDI

I.1. Profili i komunës

Prizreni shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit me një sipërfaqe prej 603 km² me një popullsi (sipas regjistrimit të vitit 2011) prej rreth 180.000 banorësh rezidentë, prej të cilëve rreth 146.000 shqiptarë, 17.000 boshnjakë, 9.000 turq dhe rreth 6.000 të tjerë. Kufizohet me komunat Gjakovë, Rahovec, Suharekë, Shtërpçë dhe Dragash, si dhe me shtetin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Prizreni është një nga qytetet më të vjetra në Evropën Juglindore që gjendet rrëzë Maleve të Sharrit dhe përgjatë Lumit Lumbardhë. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë për ekzistencën e një jete aktive në territorin e Prizrenit të sotëm qysh në antikitet. Në shekullin XIX Prizreni ishte qendra e dytë më e rëndësishme ekonomiko-tregtare e trojeve shqiptare me rreth 1.500 dyqane. Prizreni zë një vend të veçantë në historinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, u bë kryeqendër e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që u themelua me 10 Qershor 1878. Në Prizren, pati selinë e saj edhe Qeveria e Përkohshme Shqiptare (1881) e kryesuar nga Ymer Prizreni. Pas luftës së dytë e deri më 1947, Prizreni ishte qendra e Qarkut Autonom të Kosovës. Aktualisht, Prizreni është komuna më e madhe në Republikën e Kosovës, pas kryeqytetit.

Thënë këtë, Prizreni njihet si qytet me një trashëgimi të pasur kulturore dhe historike, të cilat kanë arritur të ruajnë origjinalitetin, me çka përbëjnë një atraksion për vizitorë dhe turistë. Qendra e qytetit është nyja më e rëndësishme e këtyre monumenteve të trashëgimit kulturor, por edhe Regjioni i Hasit, Kabashit dhe Vërrinit kanë numër të madh të aseteve të trashëgimit kulturor.

Një nga veçoritë më të rëndësishme të Prizrenit është turizmi, një degë e ekonomisë që ka shënuar një rritje të konsiderueshme që nga paslufta. Destinacionet më të spikatura turistike në territorin e Prizrenit janë: Kalaja, Kompleksi i Lidhjes Shqiptare, Xhamia e Sinan Pashës, Hamami i Gazi Mehmet Pashës, Shën Premta, Rrapi (Platanos-Orientalis), Manastiri i Krye-engjëjve, Kompleksi arkeologjik, krojet e shumta në rrugët e Prizrenit, Shatërvani, si dhe përqendrimi hapësinor pranë lumit Lumbardhë.

Ajo që e dallon Prizrenin në dekadën e fundit është numri i madh dhe i larmishëm i ngjarjeve kulturore, nga të cilat më të ndjekurat janë: Dokufest, Ngom Fest, Bunar Fest, Autostrada Biennale, Old Timer Fest, Festivali i Zambakut, Zgjidhimi me art dhe Koxha Ballkan.

Ekonomia e komunës së Prizrenit është kryesisht bazuar në bujqësi, tregti, ndërtim dhe përpunimit të ushqimit - të gjitha ndërmarrje private.

I.2. Administrata komunale

Administrata komunale është e organizuar në 13 drejtori: *Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Inspektorateve, Drejtoria e Kadastrës dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.*

Në kuadër të administratës, më saktësisht në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, funksionojnë edhe njësi më të vogla organizative, si: *Zyra për komunikim dhe informim, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Zyra Ligjore, Zyra e Përfaqësuesit Ligjor, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Prokurimit, Zyra për Integritet Evropian, Zyra për Çështje të Pronës, Zyra për Komunitete dhe Kthim.*

Misioni i Komunës:

Misioni i komunës është që të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, infrastrukturë dhe teknologji moderne, mundësi të njëjtë të edukimit për të gjithë, fuqi të kualifikuar punëtore. Një vend që respekton ambientin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të vet dhe të fqinjëve, me një shoqëri të hapur që promovon diversitetet dhe shkëmbim ideshë, mendimesh, duke i respektuar mendimet e të tjerëve.

1.3. Zyra për Informim Publik

Zyra për Komunikim me Publikun (ZKP) në komunën e Prizrenit përbëhet nga Udhëheqësi i Njësisë për Komunikim me Publikun, i cili mbështetet nga 2 zyrtarë të tjerë të emëruar që veprojnë në kuadër të kabinetit të Kryetarit dhe Zyra për Teknologji të Informacionit.

Zyra për Komunikim me Publikun (ZKP) kujdeset për transparencën e qeverisjes kundrejt publikut dhe siguron pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, drejtorive dhe njësisve tjera të ekzekutivit.

Në kuadër të funksioneve të saj, ZKP, siguron transparencë dhe qasje publike për punën e drejtorëve komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe mediave, si dhe koordinon organizimin dhe zbatimin e fushatave me karakter informues apo të ndërgjegjësimit.

Kjo zyrë mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre.

Po ashtu, ZKP mirëmban ueb-faqen e Komunës dhe llogaritë në platformat e komunikimit social, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë.

Vizioni i Komunës së Prizrenit në raport me informimin dhe komunikimin është që të ketë qytetarë të informuar, me mekanizma efikase të komunikimit dhe të pjesëmarrjes, duke e bërë kështu Komunën e Prizrenit të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve të saj.

1.4. Korniza Ligjore

Hartimi i kësaj Strategji është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe krijimin e parakushteve për përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L 040 - obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës.

Statuti i Komunës së Prizrenit –përcakton parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimit me qytetarë me qëllim të marrjes së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.

Rregullorja për transparencë – përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Prizrenit dhe të zyrtarëve komunal për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet dhe në proceset e vendimmarrjes në komunë.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 061-081 garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje pas kërkesës në dokumentet e mbajtura, të hartuara, apo të pranuar nga institucionet publike.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna – përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave, rregulloreve dhe akteve nënligjore të komunës.

Udhëzimi Administrativ nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna - ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike - është dokument që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat e tjera që duhet të kenë të gjitha ueb-faqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunave.

2. GJENDJA AKTUALE ME INFORMIMIN DHE KOMUNIKIMIN

Komuna e Prizrenit ka përvoja të vlefshme në aspektin e komunikimeve strategjike nga e kaluara. Në vitin 2015, Komuna hartoi *Strategjinë për Informim dhe Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2015 – 2018*, përmes të cilës vuri themelet për një komunikim të strukturuar me audiencë të ndryshme. Në përgjithësi, kjo strategji trevjeçare kishte për synim që të përmirësonte komunikimin dhe ndërveprimin me publikun, të krijonte një mekanizëm të qëndrueshëm të komunikimeve të brendshme, të rriste transparencën e veprimtarisë së komunës, të nxiste pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, të shtonte praninë në mediat lokale dhe qendrore, por edhe të vendoste një bashkëpunim sistematik me partnerët dhe donatorët e komunës.

Hartimi i këtij dokumenti strategjik dhe planit të veprimit ishte përpjekje e përbashkët e institucioneve të ndryshme të Komunës së Prizrenit, Akademisë për Trajnime dhe Asistencë Teknike (ATTA), organizatave të shoqërisë civile dhe të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Së këndejmi, viteve të fundit, Komuna e Prizrenit ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të diversifikojë kanalet e komunikimit me audiencat të ndryshme me synimin që të sigurojë një informim sa më gjithëpërfshirës, nivel të lartë të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe një ndërveprim të intensiv me mediat dhe publikun, hisedarët, partnerët dhe donatorët e komunës.

Ky komunikim përgjithësisht është realizuar përmes formave të ndryshme për komunikim me qytetarë, takimeve të strukturuar me publikun, konferencave për shtyp, komunikatave për media, paraqitjeve publike në media, intervistave, tabelave të shpalljeve, kontakteve dhe vizitave të drejtpërdrejta me qytetarë, takimeve me Këshillat e Fshatrave, takimeve në organizatat e shoqërisë civile, kontakteve afaristë, investitorë dhe donatorë, si vendorë ashtu edhe të jashtëm.

2.1. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi brenda për brenda administratës komunale ka avancuar organikisht përgjatë viteve dhe përbën një shtyllë të fortë që ka mbështetur komunikimin e jashtëm, por edhe ka dhënë një kontribut të madh në përmirësimin e praktikave të punës dhe motivimin e personelit për të përballuar me sukses dinamikat në rritje të qeverisjes lokale. Pavarësisht nga kjo, ka hapësira për ndërhyrje në mënyrë që të sigurohet një komunikim edhe më efikas në të gjitha drejtimet.

Synimi i planifikimit të komunikimit të brendshëm përmes kësaj Strategjie është që të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët (*komunikim nga lart-poshtë*), shkëmbime ndër-sektoriale (*komunikim i tërthortë*) dhe do të promovojë një kulturë organizative që promovon dëgjimin e zërit të secilit (*nga poshtë-lart*).

2.2. Informimi

Synim primar i komunës mbetet informimi i qytetarëve mbi punën e organeve të saj. Angazhimi i kryetarit të komunës, i kuvendit të komunës, i drejtorive dhe segmenteve tjera të komunës në vazhdimësi synohet që t'i prezantohet qytetarëve përmes informimit të shpejtë dhe të saktë. Publikimi me kohë i vendimeve të kryetarit të komunës, i vendimeve të kuvendit të komunës, i raporteve të punës së drejtorive të komunës me theks të veçantë i raporteve periodike financiare mbetet synim i përhershëm i komunës. Komuna e Prizrenit përmes përmbushjes së obligimeve

ligjore për informim të qytetarëve por edhe realizimit të aktiviteteve tjera të cilat i tejkalojnë kërkesat e dala nga legjislacioni, synon që të paraqesë një pasqyrë të plotë dhe reale mbi punën dhe angazhimin e organeve komunale.

Përmes një informimi të drejtë dhe me kohë të qytetarëve mbi punën e komunës hapen mundësitë për thellimin e bashkëpunimit dhe partneritetit të Komunës së Prizrenit me qytetarët e saj. Kjo më tej mundëson vendosjen e komunikimit të rregullt të komunës dhe qytetarëve dhe lehtëson pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitetet e komunës.

2.3. Komunikimet online dhe platformat sociale

Burim kryesor i informatës është ueb faqja zyrtare e komunës, i cili ofron informata të shumta mbi strukturën organizative të komunës, shërbimet e ofruara, buxhetin dhe financat, aktivitetet e prokurimit, vendimet e marra nga kryetari dhe kuvendi i komunës dhe shumë e shumë informacione me interes publik dhe në funksion të llogaridhënies dhe transparencës.

Funksionimi dhe administrimi i ueb-sajteve të komunave është i rregulluar me *Udhëzimin Administrativ të MAP Nr. 01/2015 mbi ueb-sajtet e Institucioneve Publike*. Në vitin 2018 është ndërmarrë një nismë për ri-dizajnimin e tyre, e cila kishte për qëllim integrimin e sistemit të intranetit në menaxhimin e ueb-faqeve, e për rrjedhojë edhe avancimin e shërbimeve online, gjurmimin e statusit të aplikacioneve dhe transmetimin direkt të seancave të Kuvendit. Komuna përgjatë dy viteve të fundit ka bërë shumë përpjekje që të sigurojë publikimin e të gjitha dokumenteve me rëndësi në ueb-sajtin e komunës. Një punë shumë e vlefshme është bërë në transferimin e të dhënave nga ueb-sajti i mëparshëm, e përkrah kësaj Komuna ka arritur të krijojë një infrastrukturë të mirë për të gjithë ata që kërkojnë informacionet e duhura në ueb-sajt.

Është arritur që kategoritë kryesore, si: Kuvendi, Kryetari, Financat dhe Prokurimi të jenë të pajisura me të gjitha informacionet e mundshme.

Po ashtu, pavarësisht kufizimeve në burime njerëzore dhe financiare, është bërë një punë e vyer në ofrimin e informacioneve në të gjitha gjuhët zyrtare që aktualisht janë në përdorim në komunë – shqip, serbisht, turqisht – me çka komuna sot konsiderohet një shembull për t'u ndjekur.

Përveç faqes zyrtare në internet, komuna është e pranishme me llogarinë e saj në Facebook dhe Instagram, me një numër të konsiderueshëm ndjekësish (mbi 17K), i cili në vazhdimësi ofron informacione mbi ngjarjet dhe aktivitetet e komunës dhe Kuvendit. Përmes kësaj platforme qytetarëve i ofrohen informacion në baza ditore për punën dhe zhvillimet në komunë.

2.4. Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

Në vazhden e përpjekjeve për transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve në vendimmarrje, Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren komunale për transparencë me synimin që ta harmonizojë atë me ndryshimet më të fundit në *Udhëzimin Administrativ të MAPL-së 04/2018 mbi Transparencën e Komunave*. Ky veprim është pasuar me hartimin e *Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë 2019-2023*, si një dokument i rëndësishëm për sigurimin e një transparence sa më të plotë dhe në përputhje kërkesat ligjore dhe procedurale.

Komuna mban edhe takime me qytetarë në forme të debateve publike, si dhe bashkëpunon me qytetarët si partner për realizimin e projekteve më interes të përgjithshëm. Në këtë drejtim, fokusi i Komunës për vitet në vijim është që përmbajtjen e informacioneve dhe mesazheve t'ia adaptojë natyrës specifike të platformave për komunikim social.

Pavarësisht të arriturave në aspektin e pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitetet e komunës në vitin 2019, të cilat erdhën si pasojë e aktiviteteve të strukturuar, dhe përpjekjeve pozitive të komunikimit në distancë përgjatë vitit 2020 (si pasojë e situatës epidemiologjike me COVID-19), pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes komunale mbetet një sfidë për t'u adresuar në ardhmen, qoftë përmes zbatimit të plotë të *Planit të Veprimit për Transparencë 2019-2023* ashtu edhe përmes aplikimit të metodave inovative në përputhje me Doracakun e MAPL-së për Standardet Minimale për Takime Publike.

2.5. Marrëdhëniet me mediat

Në territorin e komunës së Prizrenit operojnë një numër i madh i mediave, qoftë tradicionale apo atyre të reja, të cilat të gjitha bashkë përbëjnë një potencial të rëndësishëm për intensifikimin e informimit publik dhe komunikimit me audiencat.

Aktualisht, në Prizren operojnë tre (3) televizione me frekuenca lokale, të cilat mbulojnë ngjarjet në komunë dhe rajonin në përgjithësi – TV Besa, TV Prizreni – e që me këto dy medie komuna ka marrëveshje kontraktuale për transmetimin direkt të seancave të kuvendit, por edhe për publikimin e njoftimeve dhe shpalljeve me interes për publikun.

Një e dhënë tjetër pozitive është ekzistenca e një numri të konsiderueshëm të medimeve online (portaleve), të cilat përveçse janë shumë aktive, kanë edhe një numër të konsiderueshëm ndjekësish. Mediumet online, po ashtu, përbëjnë kanale të rëndësishme për transmetimin e njoftimeve, informacioneve, shpalljeve dhe ngjarjeve a veprimtarive të ndryshme që organizohen nga komuna dhe për komunën.

Gjatë viteve në vijim, komuna do të kërkojë që të rrisë nivelin e komunikimeve duke u bazuar mbi praktikat tashmë të etabluara të komunikimit, profesionalizmin e stafit në Zyrën për Komunikim për Informim si dhe marrëdhënie e shëndosha me mediat të ndërtuara ndër vite. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit të shtuar të mediave elektronike, platformat e komunikimit social, produksionit vizual dhe transmetimeve nga vendi i ngjarjes (livestreaming).

2.6. Bashkëpunimi me akterë të tjerë

Komuna e Prizrenit shquhet për prani dhe organizim të grupeve të ndryshme të interesit, të biznesit, kulturës, sportit të komuniteteve e të ngjashme. Mjaft aktive janë organizatat e shoqërisë civile që merren me demokratizim dhe kulturë duke mos i anashkaluar as ato rinore, të grave, të personave me aftësi të kufizuara etj. Të gjitha këto mekanizma paraqesin një potencial të madh, të cilin Komuna e Prizrenit do ta shfrytëzojë me qëllim të ndërtimit të urave komunikuese dhe partneritetit me qytetarët e saj. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) përcjellin nga afër zhvillimet politike, ekonomike, kulturore në komunë.

Ato njëkohësisht publikojnë raportet dhe vlerësimet e tyre të kohëpaskohshme mbi zhvillimet në komunë. Këto raporte dhe publikime në vazhdimësi kanë shërbyer si burim i rëndësishëm për udhëheqësit e komunës me qëllim të rritjes të në avancimin e cilësisë së qeverisjes, demokratizimit dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare të jetës publike në komunë.

Organizatat joqeveritare (OJQ) vendore kanë një trajtim të veçantë kur është fjala për pjesëmarrjen e tyre në ngjarjet komunale, hartimin e politikave dhe pasurimin e legjislacionit, apo çështjeve të tjera me interes publik. Për më tepër, OJQ-të vendore janë të përfshira në organizimin e shumë ngjarjeve publike, debateve publike dhe aktiviteteve që kanë për qëllim rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe bashkëpunimit me organet shtetërore, përfaqësive diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare me synimin e bashkërendimit të veprimeve në funksion të ngritjes së kapaciteteve të përgjithshme të komunës në sferën e qeverisjes së mirë, mirëqenies së qytetarëve, por edhe në avancimin e infrastrukturës komunale përmes projekteve kapitale. Komuna edhe në të ardhmen do të vazhdojë të kultivojë marrëdhënie të shëndosha me aktorët e këtij niveli në mënyrë që të sigurohet një mbështetje më e madhe për projektet dhe nismat që tejkalojnë kapacitete vetjake të komunës.

2.7. Promovimi dhe marketingu i Komunës

Promovimi dhe marketingu i komunës dhe aseteve të saj zhvillimore është njëra nga pikat më të spikatura të Komunës së Prizrenit. Ajo që e shquan Komunën e Prizrenit në këtë drejtim janë dy platformat e sapo lansuara të komunikimit online, të cilat kanë për synim që të në mënyrë të strukturuar të promovojnë potencialin dhe asetet e komunës tek audiencia shumë të rëndësishme për zhvillim ekonomik, siç janë: investitorët e huaj, turistët, vizitorët, etj. Platformat <https://visit-prizren.com/> dhe <https://investinprizren.com/> shquhen si për dizajne moderne ashtu dhe për informacione të bollshme që ofrohen në tre gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht dhe janë të pranishme edhe platformat sociale (Facebook, Twitter, YouTube, Instagram).

Në vitet në vijim, Komuna do të sigurohet që këto platforma të jenë të qëndrueshme, të pasurohen në vazhdimësi në mënyrë që të shërbejnë si burime të besueshme për të gjithë të interesuarit që duan të vizitojnë Prizren apo që janë të interesuar të vënë kontakte biznesi me afaristët vendorë.

2.8. Vlerësimi vetjak - Analiza SWOT

PËRPARËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT

- Praktikrat pozitive të komunikimit të brendshëm.
- Kapacitetet dhe aftësitë profesionale të zyrtarëve për të ndërtuar mesazhe të qarta dhe koncize
- Nismat pozitive në promovimin e komunës dhe aseteve zhvillimore
- Marrëdhëniet e shëndosha me përfaqësuesit e mediave dhe OJQ-ve

DOBËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT

- Mungesa e burimeve njerëzore në Zyrën për Informimi dhe Komunikim
- Interesimi në zbehje i mediave me frekuenca kombëtare për të ndjekur ngjarje të nivelit lokal
- Mosnjohja e duhur e qytetarëve mbi besueshmërinë e lajmeve që plasohen nga mediat online (portalet)
- Mungesa e një strategjie komunale për marketingun e komunës

MUNDËSITË PËR RRRITJE TË EFIKASITETIT

- Shtimi i kapaciteteve njerëzore në Zyrën

RREZIQET E MUNDSHME

- Mundësitë e kufizuara financiare të komunës për të mbështetur një plan

për Komunikim dhe Informim

- Teknologji lehtësisht të qasshme për të realizuar video promociionale me kosto të ulët.
 - Përdorimi shtuar i teknologjisë në rritjen e efikasitet në komunikim me audiencat (grupet profesionale, OJQ-të, institucionet akademike, etj.)
 - Krijimi njësisive të identitetit vizual të komunës dhe brendimi (vizioni, slogani, mesazhet promovuese, etj.) në funksion të arritjes së objektivave të komunikimit.
- intensiv komunikimi.
 - Tendenca në rritje e qytetarëve që informohen përmes burimeve dhe medimeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi – në kërkim të sensacionit
 - Rritja e vazhdueshme kërkesave për shërbime më cilësore – Rritja e pritjeve
 - Shpërqendrimi i mundshëm i zyrtarëve komunal (të emëruarit dhe staf civil) nga objektivat zhvillimor në prag të (dhe gjatë) fushatave zgjedhore

3. PLATFORMA PËR KOMUNIKIM

Komuna e Prizrenit e ka për obligim që publikut t'i ofrojë informacione mbi prioritetet, politikat, programet, projektet, strategjitë, shërbimet dhe vendimet e saj. Platforma e komunës për informim dhe komunikim do të mbështetet në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, hisedarëve dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe të kohëshme në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës. Ndërveprimi me publikun dhe audiencat relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe në besim reciprok. Kjo platformë mbështetet në elementet e mëposhtme:

Transparenca – Me rëndësi të jashtëzakonshme në këtë kontekst është transparenca e ushtruar me anë të informimit me kohë dhe përmes mjeteve adekuate të komunikimit.

Llogaridhënia – Udhëheqësit e komunës do të mbështeten në parimin e llogaridhënies për punën e tyre karshi qytetarëve të komunës, sidomos në çështjet që ndërlidhen me buxhetin, financat dhe shpenzimet e komunës.

Përgjegjshmëria – Komunikim i rregullt i autoriteteve komunale me qytetarët që siguron shkallë të lartë të përgjegjshmërisë së udhëheqësve përballë premtimeve, sukseseve dhe dështimeve eventuale të komunës.

Gjithë përfshirja – Mesazhet e autoriteteve të komunës do arrijnë tek të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit me synimin që të sigurohet një informimin i drejtë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve, komunitetit të biznesit, komunitetit kulturor, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit.

Mos diskriminimi – nënkupton informim të drejtë dhe në kohë të të gjithë qytetarëve të komunës pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni. Parimi i mos diskriminimit në të njëjtën kohë nënkupton edhe marrjen parasysh dhe adresimin nga ana e komunës së kërkesave të të gjithëve pa asnjë dallim.

Shumëllojshmëria – nënkupton shfrytëzimin e sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit duke përfshirë televizionet, radiot, gazetatat, portalet elektronike, ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, programet aplikacionet specifike të komunës etj.

Informimi me kohë – nënkupton përpjekje të vazhdueshme për informim të kohshëm në lidhje me vendimet, aktivitetet dhe planet e saj në mënyrë që qytetarët nga ana e tyre të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informatën e pranuar.

Informata kthyesë – nënkupton ofrimin i mundësisë për qytetarët që të japin komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre në lidhje me një informatë të cilin e pranojnë nga komuna. Kjo më pastaj i mundëson komunës që të ndërmarrë veprime konkrete në përputhje me kërkesat e qytetarëve me qëllim të përmirësimit të përmirësimit të performancës së saj.

4. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

Nga sa u tha më sipër, komuna e Prizrenit synon që në tre vitet pasuese të ketë personel të mirë-informuar, të respektuar dhe të përkushtuar, të fuqizohet në një institucion të aftë për t'i paraprirë ndryshimeve, të rrisë transparencën, të promovojë ndërveprimin me qytetarë dhe aktorë të tjerë, të promovojë me saktësi dhe korrektësi aktivitetet dhe arriturat e veta, si dhe të shtojë dukshmërinë e vet para publikut, qoftë përmes paraqitjeve sistematike në publik ashtu edhe përmes përdorimit të mediave të reja. Arritja e këtij qëllimi kërkon një mekanizëm solid të komunikimit dhe mesazhe të qarta, të cilat promovojnë vlerat e punës në administratën komunale, inkurajojnë punën ekipore dhe nxisin idetë inovative.

Duke u nisur nga analiza e gjendjes së përgjithshme me komunikim aktual në komunë, synimet për të avancimin e tyre në të ardhmen dhe kapacitetet financiare dhe njerëzore, Komuna e Prizrenit ka përcaktuar tre (3) objektiva kryesore të cilët do të synohet të realizohen përmes kësaj strategjie:

- 1. Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale*
- 2. Krijimi i mekanizmit efikas për komunikim dhe informim publik*
- 3. Rritja e cilësisë së informimit, transparencës, dhe ndërveprimit me qytetarë*

1. Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale
Komunikimi i strukturuar dhe koherent brenda administratës komunale dhe me audiencat e tjera të brendshme përbën një aspekt vital në përmirësimin e modelit të komunikimit dhe ndërveprimit. Intervenimet në aspektin e komunikimit të brendshëm do të orientohen në funksion të avancimit të praktikave të bashkërendimit, raportimit dhe përmirësimit të ambientit të punës me qëllim të rritjes së motivimit në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Komuna do të kryejë intervenimet e duhura për të ndërtuar një kulturë ku të punësuarit në administratën komunale ndjehen rehat dhe kanë besimin e mjaftueshëm për të shprehur mendimet e tyre në funksion të rritjes së rendimentit të punës dhe cilësisë së shërbimeve. Një gjë e tillë do të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët (*komunikim nga lart-poshtë*), shkëmbime ndërsektoriale (*komunikim i tërthortë*) dhe do të promovojë një kulturë organizative që promovon dëgjimin e zërit të secilit (*nga poshtë-lart*). Kornizat e komunikimit të brendshëm të përcaktuara në kuadër të kësaj strategjie do të shërbejnë si kornizë udhëheqëse për administrimin e komunikimeve dhe do të azhurnohen sipas nevojave dhe në përputhje me vizionin dhe objektivat strategjik të administratës komunale.

2. Krijimi i mekanizmave efikas për komunikim dhe informim publik

Komuna e Prizrenit ka njohur zhvillime shumë pozitive në aspekt të komunikimeve të jashtme, dhe stadi zhvillimor në të cilin ndodhet aktualisht komuna kërkon ribalancim prioritetesh ashtu që vëmendja në të ardhmen të përqendrohet më shumë në promovimin e projekteve dhe programeve konkrete dhe më pak në punët e përditshme rutinore, të cilat tashmë kanë protokolle të mirë-etabluara dhe zhvillohen me efikasitet. Do të synohet përmes paraqitjeve të strukturuar mediale, diversifikimit të kanaleve dhe materialeve komunikuese, përdorimit të shtuar të mediave të reja dhe digjitale dhe ndërveprimit të shtuar përmes faqes zyrtare të komunës në Internet. Në vitet në vijim, komuna synon që të rrisë praninë e saj në platformat sociale, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Përpara hapjes së llogarive në platformat e tjera sociale, Komuna do të sigurohet që personeli në ZKP të trajnohet për përdorimin korrekt dhe efikas të tyre. Po ashtu, në vitin e dytë dhe të tretë të kësaj strategjie, Komuna do të angazhohet që të hartojë një strategji marketingu në mënyrë që të promovojë vlerat dhe asetet e saj turistike, kulturore dhe historike. Përmes strategjisë së marketingut të komunës do të synohet që të nxitet interesi i vizitorëve, por edhe i investitorëve të mundshëm në të ardhmen.

3. Rritja e cilësisë së informimit, transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë

Synimi parësor i kësaj Strategjie është që t'i mundësohet qytetarëve të komunës jo vetëm një qasje e lehtësuar në informacionet mbi aktivitete e Komunës, por edhe të nxisë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të instalojë një qasje komunikimi e cila merr në konsideratë preferencat e qytetarëve dhe audiencave tjera dhe për rrjedhojë hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi. Thënë kështu, përmes kësaj strategjie komuna do të mirëmbajë mekanizimin efikas të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje (përmes zbatimit të plotë të Planit të Transparencës 2019-2023); të ndërtojë marrëdhënie të mira me qytetarët, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e mbështetësit tonë. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të komunikimit digjital, sidomos në raport me informimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit në vendimmarrjen komunale.

5. KANALET E KOMUNIKIMIT

Duke marrë parasysh zhvillimet e mediave të reja dhe kërkesat e kësaj strategjie, Komuna e Prizrenit do të rishikojë kanalet e komunikimit me audiencat e jashtme në mënyrë që aktivitetet, nismat dhe projektet e ndërmarra të pasqyrohen me korrektësi dhe të marrin vëmendjen e merituar të publiku. Përgjithësisht, komunikimet e Komunës me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve të renditura më poshtë:

Emaili - Në një institucion zyrtar, emaili është një kanal i pazëvendësueshëm komunikimi edhe për faktin se përmbajtjet e mesazheve të emailit kanë pothuajse një status të komunikimit zyrtar. Duke pasur parasysh këtë fakt, është shumë me rëndësi që të punësuarit administratën komunale t'i avancojnë njohuritë për përdorimin e duhur dhe efikas të llogarive zyrtare, përtej normave të përcaktuara me rregullore dhe udhëzime administrative. Për këtë arsye, që në vitin e parë të kësaj Strategjie, Komuna do të shpërndajë *Udhëzuesin për përdorimin e duhur dhe efikas të komunikimit me email*.

Intraneti qeveritar - Është një platformë e mirë për vendosjen e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve relevante në një vend të vetëm, mundëson një qarkullim të lirë të informacionit dhe përbën një medium ku të punësuarit mund të shprehin idetë dhe mendimet e tyre. Për më tepër, intraneti është një kanal që mundëson qasje të lehtë dhe të shpejtë në informacionet zyrtare për të gjithë të punësuarit në administratën komunale.

Aplikacionet qevritare - janë një mundësi e mirë për komunikim dhe koordinim të brendshëm dhe ndërinstytucional sepse ofrojnë mundësojnë komunikimin përmes pajisjeve që sot secili i punësuar i ka në dispozicion. Aplikacionet mundësojnë një komunikim të atypëratyshëm në secilën periudhë të ditës dhe në pavarësi të plotë nga lokacioni apo pasja e një kompjuteri. Në të ardhmen Komuna do të përpiqet që të shtojë përdorimin e aplikacioneve zyrtare të licencuara dhe që plotësojnë standardet e sigurisë dhe cilësisë dhe që janë në pronësi të Qeverisë, si për shembull *Skype for Business* dhe *Microsoft Teams*. (Këto aplikacione mund të përdoren pa kosto shtesë në kuadër të domenit qeveritar).

Ueb-faqja e Komunës <https://kk.rks-gov.net/prizren/> mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Vështirësitë e hasura pas ridizajnit të faqes zyrtare të komunës janë tejkaluar dhe ajo do të ushqehet me informacionet relevante në funksion të informimit publik dhe qeverisjes së mirë dhe transparente.

Platformat <https://visit-prizren.com/> dhe <https://investinprizren.com/> shquhen si për dizajne moderne ashtu dhe për informacione të bollshme që ofrohen në tre gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht dhe janë të pranishme edhe platformat sociale (Facebook, Twitter, YouTube, Instagram). Në vitet në vijim, Komuna do të sigurohet që këto platforma të jenë të qëndrueshme, të pasurohen në vazhdimësi në mënyrë që të shërbejnë si burime të besueshme për të gjithë të interesuarit që duan të vizitojnë Prizren apo që janë të interesuar të vënë kontakte biznesi me afaristët vendorë.

Platformat e komunikimit social – Duke pasur parasysh rritjen gjithnjë e më të madhe të popullaritetit të mediave të reja (digjitale), komuna do të kërkojë për forma më efikase të pranisë së vet në platformat sociale. Në momentin aktual, Komuna e Prizrenit është e pranishme në platformën sociale Facebook, Instagram dhe YouTube. Prania në platformat tjera sociale është një aspekt që do të adresohet që në vitin e parë (2021) me qëllim të hapjes së sa më shumë kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes së sa më shumë audiencave në komunikimet e ditëpërditshme.

Mediat – janë një kanal i rëndësishëm i komunikimit me publikun dhe audiencat tjera dhe Komuna në vazhdimësi është përpjekur të kultivojë marrëdhënie të shëndosha me përfaqësuesit e tyre. Zyra për Komunikim dhe Informim do të krijojë lista të konsoliduar të mediave me frekuenca lokale dhe kombëtare me qëllim që të pasqyrojë ngjarjet që meritojnë vëmendjen e publikut Prania e televizioneve dhe radiove lokale është një përparësi, e cila do të shfrytëzohet për paraqitje të strukturuar. Mediat online (portalet) me mbulim lokal, po ashtu, janë të shumta në numër dhe përbëjnë kanale të rëndësishme të transmetimit të informacioneve dhe mesazheve të komunës.

Paraqitjet publike dhe në media – janë një formë efikase për t'iu drejtuar audiencave të ndryshme për çështje specifike dhe me rëndësi për zhvillimet në komunë. Në këtë kuadër do të intensifikohen konferencat për shtyp (të rregullta dhe të rastit), intervistat dhe debatet në media, takime jorformale me përfaqësuesit e mediave, inaugurime dhe promovim e nismave të

ndryshme, shkrime autoriale dhe opinione për çështje specifike që ndërlidhen me qeverisjen lokale, etj.

Publikimet - janë një aspekt kyç i punës së komunës dhe prezantimit të saj. Ana përmbajtjesore dhe vizuale e publikimeve zyrtare do të rishikohet në mënyrë që të jenë më të kuptueshme dhe vizualisht më estetike, e për rrjedhojë edhe më të lexueshme nga publiku dhe grupet e interesuara. Po ashtu, si publikimet formale ashtu edhe ato me karakter promovimi dhe marketingu apo ato me karakter informimi e ndërgjegjësimi do të standardizohen në përputhje me parimet udhëheqëse të parapara me strategjinë e marketingut dhe brendimit.

Videot dhe fotografitë - Rëndësia e imazheve (videot dhe fotografitë) në komunikimet digjitale është rritur në mënyrë dramatike që nga dalja në skenë e platformave për komunikim social. Videot dhe fotografitë, edhe si të vetme dhe e pashoqëruar me narracion, ka aftësinë për të kapur vëmendjen e audiencës, duke gjeneruar interesim dhe përfshirje emocionale.

Takime të strukturuar dhe të planifikuara për organizimin dhe udhëheqjen e takimeve publike të natyrave konsultative – takimet dhe debatet publike, takimet konsultative, dëgjimet buxhetore, takimet komunitare për nisma dhe projekte kapitale, etj.

Tabelat e informimit – Komuna do të përkujdeset që në vendet më të frekuentuara të zonave urbane dhe rurale të vendosë tabelat të informimit të qytetarëve, në mënyrë që njoftimet, informacionet dhe mesazhet që duhen përcjellë te qytetarët të jenë të dukshme dhe të disponueshme për sa më shumë të interesuar.

6. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

Përmes kësaj strategjie komuna e Prizrenit kërkon të vendosë marrëdhënie të shëndosha dhe me interes reciprok me një numër të madh audiencash duke përcjellë mesazhe e dhura te audiencat e dhura dhe duke respektuar mendimin e tyre në raport me çështjet e përbashkëta të interesit. Tabela më vijim, paraqet në formë të detajuar audiencat me të cilat synon të komunikojë komuna në një mënyrë të organizuar dhe të strukturuar përmes mesazheve të qarta dhe që nuk lënë hapësira për dëmtimin e marrëdhënieve reciproke.

AUDIENCAT	MESAZHI: Çfarë duam që ata të mendojnë për ne?	IMPAKTI I DËSHIRUAR: Çfarë veprimesh presim nga ta?
Qytetarët dhe taksapaguesit e të gjitha kategorive	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna e Prizrenit është e përkushtuar që përmirësojë cilësinë e qeverisjes. • Shërbimet e komunës janë me kosto të arsyeshme dhe janë në përmirësim çdo ditë. • Komuna mirëpret pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve në 	<ul style="list-style-type: none"> • Të shprehen pozitivisht për cilësinë e shërbimeve, qeverisjes dhe demokracisë në komunë. • Të kenë mirëkuptim për efikasitetin dhe koston e shërbimeve që marrin nga komuna. • Të kenë mirëkuptim për

	<p>vendimmarrje.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komuna shpenzon me përgjegjësi dhe efikasitet paratë e taksapaguesve dhe donatorëve. 	<p>planifikimin e investimeve kapitale dhe rëndësinë e tyre për objektivat zhvillimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kenë një perceptim pozitiv mbi përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike
Mediat	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëheqja komunale është e përkushtuar për të rritur cilësinë e shërbimeve. • Komuna e Prizrenit i shpenzon paratë e taksapaguesve në mënyrë të përgjegjshme dhe në interes të zhvillimit të komunës. • Komuna është e hapur ndaj të gjitha interesimeve tuaja. • Mbështetja juaj është e domosdoshme në luftimin e korrupsionit dhe keqqueverisjes. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të mbulojnë ngjarjet që ndërlidhen me komunën në mënyrë të kohshme, saktë, të sinqertë dhe të paanshme. • Të raportojnë për nismat dhe projektet pozitive të komunës • Ta konsiderojnë administratën komunale një burim të besueshëm të informacionit. • Të ofrojnë kontributin e tyre në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së qeverisjes
Organizatave shoqërisë civile dhe organizatat profesionale	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna është e hapur për bashkëpunim dhe mirëpret kontributin e OSHC-ve dhe organizatave profesionale • Komuna do të mbështesë nismat dhe projektet e shoqërisë civile që kanë për synim përmirësimin e cilësisë së standardeve demokratike në komunë. • OSHC-të janë një aleat i besueshëm i komunës në avancimin e praktikave të transparencës në shpenzimin e fondeve publike 	<ul style="list-style-type: none"> • Ta konsiderojnë komunën si partner të rëndësishëm në mbështetjen e nismave dhe kauzave të tyre • Të marrin pjesë aktivisht në vendimmarrje dhe të nxisin pjesëmarrjen dhe qytetarinë aktive • Të mbështesin përpjekjet e komunës për qeverisje gjithëpërfshirëse. • Të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve komunale
Komuniteti i biznesit dhe investitorët e mundshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna e Prizrenit mbështetë krijim e një ambienti miqësor për të bërit biznes. • Politikat tona fiskale janë të favorshme për zhvillimin e biznesit. • Administrata komunale është e përkushtuar që të rrisë nivelin 	<ul style="list-style-type: none"> • Ta konsiderojnë komunën si një partner të besueshëm në zhvillimin e bizneseve të tyre. • Të flasin pozitivisht për nismat dhe përpjekjet e komunës në përmirësimin e ambientit afarist në komunë. • Të kontribuojnë profesionalisht në

Institucionet e Kosovës (Qeveria, Kuvendi i Republikës, agjencitë qeveritare, etj)

- e cilësisë së shërbimeve.
- Komuna synon të jetë një vend i mundësive dhe nxitëse e inovacionit.
- Mbështetja e Qeverisë është jashtëzakonisht e rëndësishme për zhvillimin e komunës.
- Administrata komunale është shumë e motivuar për të rritur cilësinë e shërbimeve.
- Investimet kapitale janë gjithmonë të menduara mirë dhe në përputhje me vizionin zhvillimor të komunës.
- Komuna ka nevojë për mbështetjen e qeverisë në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme

- përmirësimin e politikave dhe strategjive zhvillimore.
- Të inkurajojnë investitorët e huaj të investojnë në Prizren.
- Të mbështesin vizionin tonë për zhvillim të komunës.
- Të kenë parasysh specifikat e komunës dhe nevojave për fonde shtesë.
- Të mbështesin nismat tona dhe kërkesat për investime kapitale.
- Të mbështesin kërkesat tona për zhvillimin profesional të personelit të administratës komunale.

Partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët

- Komuna e Prizrenit është e përkushtuar të përmirësojë cilësinë e qeverisjes.
- Komuna e Prizrenit është e përkushtuar që të forcojë sundimin e ligjit.
- Komuna e Prizrenit i mirëpret dhe i shfrytëzon kontributet e donatorëve në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme.
- Komuna e Prizrenit është një partner i besueshëm që kujdeset për qëndrueshmërinë e projekteve dhe investimeve.

- Të flasin me pozitivitet mbi bashkëpunimin dhe partneritetin me komunën.
- Të na mbështesin në avokimin për grumbullimin e fondeve për qëllime zhvillimore.
- Të përdorin autoritetin e tyre për më shumë fonde për komunën.
- Të mbështesin komunën në rritjen e cilësisë së qeverisjes dhe demokracisë.
- Të mbështesin komunën në forcimin e rendit dhe ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

7. INTERVENIMET NË MEKANIZMAT E KOMUNIKIMIT

Në funksion të realizimit të objektivave të kësaj Strategjie, Komuna e Prizrenit në tre vitet pasuese do të kryejë disa ndërhyrje, të cilat janë të dizajnuara të përmirësojnë mekanizmat e komunikimeve në tërësinë e vet.

Intervenimet e parapara me këtë strategji janë dizajnuar si rrjedhojë e një analize gjithëpërfshirëse të proceseve dhe mekanizmave të komunikimit dhe efikasitetit të tyre në performancën e komunës në disa elemente kyçe. Mbi bazën e kësaj analize janë identifikuar mundësitë për përmirësim, të cilat janë përkthyer në objektiva, mesazhe dhe kanale të komunikimit dhe mekanizma për marrjen e informatave kthyesë.

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e objektivave të kësaj strategjie, Komuna do të krijojë mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të zyrtarëve për informim, kurse në raste të veçuara do të angazhojë edhe ekspertë të jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale. Për më tepër, Komuna do të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet akademike (universitetet) me qëllim të përfitimit reciprok në ngritjen e cilësisë dhe performancës në punë.

Këto intervenime dhe aktivitetet të tjera, në trajtë të strukturuar do të paraqiten në planet vjetore të kësaj strategjie.

Praktikat e komunikimit të brendshëm në administratën komunale (Objektivi 1)

- Hartimi i Udhëzuesit për Komunikim me llogaritë zyrtare të emailit (nga USAID)
- Azhurnimi i programit të trajnimeve në funksion të ngritjes teknike dhe profesionale të të punësuarve në bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Zëvendësimi i pajisjeve/mjeteve teknologjike të vjetruara apo të dala jashtë funksionit.
- Zbatimi i procedurave standarde për plasimin e informatave në websajtin e komunës në përputhje me doracakun për publikimin e akteve dhe politikave publike në nivel komunal
- Përdorim i shtuar i intranetit qeveritar dhe aplikacioneve qeveritare për komunikim në distancë dhe punët ekipore (*Skype for Business, Microsoft Teams*)
- Mbledhje të rregullta të udhëheqësve të sektorëve me personelin që kanë në mbikëqyrje.
- Mbledhje të rregullta mujore të Kryetarit apo Nënkyetarit me drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike
- Takimet e përgjithshme me stafin e administratës komunale (së paku dy herë në vit) për të diskutuar çështje që ndërlidhen me dhe për objektivat dhe planet e qeverisë komunale si dhe për aspektet organizative të administratës komunës (aspektet e administratës, financave, logjistikës, zhvillimit të kapaciteteve profesionale, etj.)
- Organizimi i ngjarjes të funditvitit me të punësuarit në administratën komunale për t'i falënderuar (dhe shpërblyer performuesit më të mirë) për kontributin e dhënë.

Krijimi i mekanizmit efikas për komunikim dhe informim publik (Objektivi 2)

- Zhvillimi i njësisë të standardizuara të identitetit vizual të Komunës (flamuri, dhuratat, mirënjohjet, njësitë me karakter promovues, raportet, dosjet, fletoret, lapsat, prezantimet Power Point, etj.)
- Krijimi i email listave të grupuara për komunikime me mediat, OSHC-të, grupet profesionale, organet qeveritare/shtetërore dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Angazhimi praktikantëve universitarë në ZKI përmes një Memorandumi të Mirëkuptimit
- Diversifikim i materialeve dhe kanaleve të komunikimit, sidomos videove dhe transmetimeve livestream; Përqendrim i shtuar te produktet audio-vizuale në funksion të

- promovimit të aseteve zhvillimore të komunës (lokacionet e trashëgimisë kulturore dhe historike, destinacionet turistike, zonat ekonomike, etj.)
- Ndërhyrjet në infrastrukturën e websajtit komunës për organizimin dhe kategorizim më të mirë të informacioneve që shërbejnë për publikun (raportet e ekzekutivit, financat e komunës, raportet e auditiveve, prokurimit, etj.) në përputhje me udhëzimet edhe rekomandimet e MPL-së.
- Organizimi i konferencave për shtyp për çështjet dhe ngjarjet me rëndësi në Komunë
- Takime koordinuara me afaristët, investitorët dhe donatorët e mundshëm
- Emërimi i koordinatorit komunal nga kabineti i kryetarit për bashkërendimin e aktiviteteve me përfaqësitë diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare
- Kontakte të rregullta (edhe nëpërmjet pajisjeve dhe aplikacioneve për komunikim në distancë) me përfaqësuesit lokal në diasporë
- Hartimi i Strategjisë komunale për marketing në bashkëpunim me grupet profesionale dhe donatorët (viti 2022)
- Publikimi i broshurës elektronike “Investimet në Komunën e Prizrenit 2014-2020
- Realizimi i videove me lokacionet dhe ngjarjet më të rëndësishme kulturore të komunës (4 për secilin vit)
- Takime tematike të Kryetarit të Kuvendit dhe KPF-së me diasporën mbi shërbimet, klimën e investimeve dhe zhvillimin ekonomik të komunës
- Organizimi i ngjarjes “Dita e Dyerve të Hapura të Komunës” në sezonin e diasporës.
- Organizohen takime të rregullta me bizneset dhe asociacionet për të përmirësuar mjedisin afarist

Rritja e cilësisë së informimit, transparencës, dhe ndërveprimit me qytetarë (Objektivi 3)

- Zbatimi efikas i Planit të Veprimit për Transparencë 2019-2023;
- Transmetimi i seancave të Kuvendit të Komunës nëpërmjet websajtit të Komunës dhe kanalit në YouTube
- Aplikimi i formave të reja/inovative të takimeve dhe konsultave publike në përputhje me Doracakun për Standardet Minimale për Organizimin e Konsultimeve Publike;
- Organizimi i dëgjimeve buxhetore në përputhje me tiparet dhe karakteristikat e audiencave;
- Takime të formateve bashkëkohore me organizatat e shoqërisë civile.
- Përdorim i shtuar i mediave të reja dhe platformave sociale në funksion të informimit, komunikimit dhe promovimit të aktiviteteve të komunës.
- Përgatitja dhe transmetimi i buletini televiziv mujor mbi ngjarjet më të rëndësishme në komunë përmes marrëveshjeve kontraktuale me televizionet lokale.
- Organizimi i konferencave për shtyp për prezantimin e raporteve periodike të Kryetarit të Komunës.
- Publikimi i broshurës elektronike për të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet publike dhe shpërndarja përmes kanaleve në dispozicion të komunës.
- Vizitë studimore në Mal të Zi mbi praktikën e mira të informimit dhe komunikimit me publikun

8. BUXHETI PROVIZOR PËR VITIN 2022

OBJEKTIVI

	KOSTOJA (€)
(1) Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale	0
(2) Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe ndërveprimit me qytetarë	0
(3) Promovimi i komunës, aktiviteteve dhe aseteve komunale	0
GJITHSEJTË	0

9. PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI

Zbatimi i kësaj strategjie do të mbështetet në planet vjetore të veprimit. (Shih Shtojcën 1 për planin e veprimit për informim dhe marrëdhënie me publikun 2021). Vlerësimi i zbatimit të planit për komunikim dhe informim do të bëhet mbi baza vjetore nga Kabineti i Kryetarit në këshillim me Zyrën për Komunikim dhe Informim. Gjetjet mbi realizimin e planit do të shërbejnë si udhëzues për hartimin e planeve vjetore pasuese – 2022 dhe 2023.

10. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kryetari i Komunës

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Nxit, promovon dhe mbështetë kulturën e komunikimit të hapur dhe efikas brenda administratës komunale dhe kujdeset për një komunikim të shëndoshë me audiencat e jashtme.

Mbështetë zbatimin efikas të kësaj Strategjie.

Zyrtarët për Media në kabinetin e Kryetarit

Mbikëqyrin zbatimin e kësaj Strategjie. Janë përgjegjës për vlerësimin periodik (vjetor) të zbatimit të kësaj strategjie.

Drejtorët e drejtorive komunale

Nxisin dhe mbikëqyrin zbatimin e kësaj strategjie brenda drejtorive të tyre dhe informojnë Kryetarin dhe Nënkryetarin e komunës për progresin në zbatimin e saj. Furnizojnë ZKI me informacione të cilat meritojnë

Zyra për Komunikim me Publikun (ZKP)

Të punësuarit në administratën komunale

publicitetet dhe vëmendje të publikut. Koordinohen me ZKI dhe me Kabinetin e Kryetarit për paraqitjet e tyre në media dhe publik. Informojnë personelin e drejtorive me të cilat udhëheqin me zhvillimet që ndërlidhen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës dhe inkurajojnë shprehjen e lirë të tyre në planifikim dhe vendimmarrje.

Është përgjegjëse për të mirëmbajtjen e faqes zyrtare të komunës në internet dhe llogarive në platformat sociale. Është përgjegjëse për informimin e saktë dhe të kohshëm përmes kanaleve të komunikimit në dispozicion të komunës.

Kontribuon në pasurimin e formave të komunikimit dhe mbanë të informuar Kryetarin e Komunës për mbarëvajtjen e komunikimit të jashtëm. Në bashkëpunim me kabinetin e kryetarit sigurohet për zbatimin e plotë të Planit të Transparencës. Sigurohet që të punësuarit e administratës dhe audiencat tjera të kenë informacionet e nevojshme mbi ngjarjet që ndërlidhen me ekzekutivin e komunës.

Kontribuojnë në format që zgjedhin ata për të përmirësuar praktikën e komunikimit në administratën komunale. Bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive me eprorët e tyre në funksion të përmirësimit të komunikimit

SHTOJCAT

Shtojca 1. Plani i Veprimit për Komunikim, Informim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2021

Shtojca 2. Plani i Veprimit për Transparencë 2019-2023

Shënim zyrtar: Strategjia Komunale për Informim, Komunikim dhe pjesëmarrje qytetare, është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prizrenit të mbajtur më 31 mars 2022.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Antigona Bytyqi

